



REPUBLIKA E KOSOVËS /  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C nr. 268/11

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Lumni Sallauka, me sekretaren juridike Raxhije Emini, në kontestin e paditësit H. G. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale për Arsim në Prizren, të cilën e përfaqëson avokati publik komunal Besim Morina, me objekt të padisë kompensimin e pagave përcjellëse në pension dhe shpërblimit jubilar, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë **27.12.2013** mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit H. G. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit, Drejtoria për Arsim, që paditësit t'i paguaj dy paga në emër të shpërblimit jubilar, në shumën prej 593.08 € dhe dy paga për përcjellje në pension në shumën prej 593.08 €, si dhe në emër të regresit shumën prej 120€, apo gjithësejtë shumën prej 1306.16 €.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi H. G. në seancën kryesore, ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë të cekurave në padi dhe kërkesëpadi, si dhe në deklaratat e mëherëshme, Më tutje ka theksuar se ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, i caktuar në vendin e punës si mësimdhënës në Shkollën e Mesme Ekonomike “Ymer Prizreni” në Prizren. Me vendimin e Drejtorisë së Arsimit në Prizren, të datës 17.06.2010, është pensionuar për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare. Pas pensionimit me kërkesë i është drejtuar të paditurës që në emër të pagave përcjellëse për pension, konform nenit 44 të Kontratës kolektive të vitit 2004 ti paguajë dy paga mujore në emër të shpërblimit jubilar dhe dy paga për shkuarje në pension, mirëpo kjo e fundit e më datë 31.01.2011, refuzon këtë kërkesë si të pabazë. Në fund deklaroi se i propozon gjykatës që padinë e tij gjykata ta aprovon në tërësi si të bazuar. Shpenzimet procedurale nuk i kërkoi.

Përfaqësuesi i të paditurës avokati publik komunal Besim Morina në shqyrtimin kryesor deklaroi se mbetet në tërësi si në të cekurat në përgjigjën në padi, përmes të cilave e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, pasi ka konsideruar se e paditura në këtë rast Komuna e Prizrenit nuk ka legjitimacion pasiv që të jetë palë e paditur në këtë rast dhe thekson se paditësi kërkesëpadinë e tij e bazon në Kontratën e Përgjithshme Kolektive e nënshkruar në mes të Sindikatës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe

nuk e obligon Komunën pasi ajo nuk është nënshkruese e kësaj Kontrate. Ka kërkuar nga gjykata që pas vlerësimit të provave të administruara të refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Në këtë drejtim gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: vendimin e Qendrës Rajonale Prizren- Departamenti i Administratës Pensionale për njohjen e të drejtës në pension bazë dhe kontributiv i datës 17.06.2010, përgjigjen e Drejtorisë Komunale të Arsimit Prizren, nr. 107/11, të datës 31.01.2011, me të cilën është refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e pagës përcjellëse për shpërblim jubilar, kontratën kolektive, vërtetimin e Shkollës së Mesme Ekonomike në Prizren nr. 1138 të datës 16.12.2013, në bazë të të cilës konstatohen shumat e pagesës në tremujorin e fundit.

Gjykata pas vlerësimit të provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e **pabazuar**.

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi tek e paditura ka qenë në marrëdhënie pune, i caktuar në vendin e punës mësimdhënës në Shkollën e Mesme Ekonomike “Ymer Prizreni” në Prizren, ndërsa në bazë të vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të shkuarjes në pension të paditësit, të datës 17.06.2010, i ndërprehet marrëdhënia e punës (efektivisht ka punuar deri me datë 31.08.2010, sipas udhëzimit administrativ të Ministrisë së Arsimit, më saktësisht deri në përfundim të gjysëmvetorit të dytë).

Paditësi përmes kërkesës së veçantë, ka kërkuar nga e paditura që ti paguajë dy paga mujore në emër të shpërblimit jubilar, mirëpo përmes përgjigjes nr. 107/10 të datës 31.01.2011, kjo e fundit e refuzon kërkesën e paditësit si të pabazuar.

Në bazë të vendimit të Shkollës së Mesme Ekonomike në Prizren nr. 1138 të datës 16.10.2013, vërtetohet fakti se paditësi në tre muajt e fundit ka realizuar pagën mujore në shumë prej **324.32 €**.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të administruara gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet. Kjo për faktin se kërkesa për kompensimin e pagave jubilarë dhe për përcjellje në pension është në kundërshtim me dispozitat ligjore përkitazi në lidhje me zbatimin e nenit 44 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive, pasi që kjo kontratë ka filluar të zbatohet me datën 01.01.2005 dhe zbatimi i saj ka vazhduar për tri vite, përkatësisht deri në fillim të vitit 2008, ku edhe të njëjtës i ka skaduar afati, ndërsa me skadimin e afatit kjo kontratë nuk ka veprim të mëtutjeshëm dhe nuk mund të zbatohet për raste të tjera. Ndërsa kërkesëpadia e paditësit në gjykatë është paraqitur me datë 11.05.2011. Edhe në bazë të dispozitave të kontratës kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi me datë 27.10.2005, paditësit nuk i takojnë të ardhurat e kërkuar me kërkesëpadi, pasi që edhe kjo kontratë ka pasur kohëzgjatje prej 3 vitesh, bazuar këtu në parag. 4 të nenit 90 të Ligjit të Punës që është në fuqi dhe nenit 6.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës.

Ndërsa, pretendimin e përfaqësuesit të të paditurës se kjo e fundit nuk ka legjitimacion pasiv në këtë çështje juridike pasi e njëjta nuk e ka nënshkruar këtë kontratë, gjykata nuk e pranoi për faktin se bazuar në Ligjin Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitat e Kosovës, më saktësisht neni 4 i këtij ligji thotë “ *Komunitat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për atë që ato i takojnë interesit lokal, ndërkohë që respekton standardet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi në lidhje me dispozitat e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrjen në punë, pagesën e rrogave dhe aftësimin e mësimitdhënësve dhe administratorëve*”, ku çështja e pagesave për mësimitdhënës është bartur nga Ministria e Arsimit tek Komunitat, andaj në rastin konkret e paditura ka legjitimitet pasiv në këtë çështje juridike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform neni 450 të LPK-së, ku është obliguar që secila palë ti bartë shpenzimet procedurale.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform neni 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN**  
**C.nr.268/11, datë 27.12.2013**

**Sekretare Juridike,**  
Raxhije Emini

**Gjyqtari,**  
Lumni Sallauka

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.